



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË MITROVICË



Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, për periudhën kohore Prill-Qershor 2024.

Aktakuzë kundër katër zyrtarëve të Ndërmarrjes Trepça SH.A për Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe Konflikt interesi

Mitrovicë, 15 prill 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, kundër të pandehurve H.U., Q.B., S.I., dhe Xh.T për shkak të dyshimit të bazuar mirë për kryerjen e veprës penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", dhe ndaj Xh.T, edhe për veprën penale "Konflikti i interesit".

Të pandehurit H.U., Q.B., S.I., akuzohen se në cilësinë e personave zyrtarë në ndërmarrjen "Trepça" SH.A, me dashje duke e shfrytëzuar detyrën zyrtare i tejkalojnë kompetencat e tyre dhe nuk i përmbushin detyrën zyrtare me qëllim që personi A.T., të përfitojë dobi, ashtu që duke mos përfillur dispozitat ligjore për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, i pandehuri H.U., në cilësinë e kryetarit të komisionit dhe të pandehurit Q.B., S.I., në cilësinë e anëtarëve të komisionit për pranimin e një punonjësi - vozitësi të menaxherit në ndërmarrjen "Trepça" SH.A, e përpilojnë dhe nënshkruajnë raportin për propozimin e kandidatit të vetëm A.T., për pranimin në pozitën e shoferit, edhe pse e kanë ditur se në këtë rast duhet përsëritur konkursi pasi që nuk kanë qenë tre (3) kandidatë që i plotësojnë kushtet me konkurs.

Ndërsa, i pandehuri Xh.T., në cilësinë e personit zyrtar U.D Menaxher i Ndërmarrjes "Trepça" SH.A, akuzohet se me dashje nuk i përfillë dispozitat ligjore, duke tejkaluar kështu kompetencat e tij dhe nuk i përmbushë detyrat zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për personin A.T., ashtu që konkursi për pozitën vozitës i menaxherit të Ndërmarrjes "Trepça" SH.A., edhe pse është dashur të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e publikimit, i njëjti konkurs ka mbetur i hapur vetëm tetë (8) ditë, e po ashtu është dashur të përsëritet konkursi pasi që nuk kanë qenë tre (3) kandidatë që i plotësojnë kriteret e parapara me konkurs.

Po ashtu, i pandehuri Xh.T., në cilësinë e personit zyrtar U.D Menaxher i Ndërmarrjes "Trepça" SH.A me dashje nuk i përfillë dispozitat ligjore të "Ligjit për parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik" dhe merr pjesë personalisht në çështje zyrtare në të cilën anëtari i familjes së tij ka interes financiar, ashtu që merr vendimin Nr. 809 të datës 29.03.2019 mbi pranimin në marrëdhënie pune të vëllaut të tij A.T., në kohë të pacaktuar në pozitën "Vozitës" në këtë ndërmarrje.

Me këto veprime, të pandehurit kanë kryer veprat penale të cilat u vihen në barrë.

Prokurori i Shtetit, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shpallë fajtor për veprat e kryera penale dhe ta dënojë sipas ligjit.

Kërkesë për paraburgim për marrje dhe dhënie ryshfeti, i përfshirë një zyrtar i ATK në Mitrovicë

Mitrovicë, 25 prill 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit për të dyshuarin Q.M., inspektor i Administratës Tatimore të Kosovës në Mitrovicë, pasi ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale “Marrja e ryshfetit” nga neni 421 paragrafi 1 të KPRK, dhe për S.S., nga Novi Pazari, për shkak të dyshimit për kryerjen e veprës penale “Dhënia e ryshfetit” nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

I dyshuari Q.M., inspektor i ATK në Mitrovicë, dyshohet se me datë 24 prill 2024, në parkingun e Terminalit Doganor në Mitrovicë, si person zyrtar në mënyrë të drejtpërdrejtë ka pranuar shumën e të hollave prej njëqindetridhjetepesë (135) euro, në mënyrë që të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

I dyshuari S.S., dyshohet se me qëllim të lehtësimit të procedurave për lirim të mallit, i jepë dhuratë personit zyrtar shumën prej njëqindetridhjetepesë (135) euro, e gjithë kjo me qëllimin që i njëjti të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

Seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve pritet të mbahet ditën e premte, datë 26 prill 2024, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Kërkohet caktimi i paraburgimit për të pandehurin për laboratorin e drogës në Leposaviq

Mitrovicë, 08 maj 2024


Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit për të pandehurin M.I., pasi ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprat penale “Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike” nga neni 268 paragrafi 1 të KPRK, dhe “Mbajta ne pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjatë kontrollit në shtëpinë e të pandehurit M.I., në fshatin Miokovicë, komuna Leposaviq janë gjetur dhe sekuestruar pushkë me dy tyta të gjata, fishekë për pushkë gjuetie, një fishek për armë të gjatë, dy radiolidhje, adapterë për radio lidhje, një jakne e uniformës së Policisë së Kosovës në të cilën kishte doreza të zeza, maskë për mbulimin e fytyrës dhe syza të zeza, ndërsa në objektin përcjellës laborator i improvizuar për kultivimin e narkotikëve, ku janë gjetur katërqindeshtatë (407) bimë të dyshuara të Kanabisit, me gjatësi prej 5-13 cm, nëntë (9) gramë të dyshuar të substancës narkotike, si dhe mjete tjera që shërbejnë për kultivimin e bimëve narkotike.

I pandehuri, me aktvendim të prokurorit të shtetit gjendet në paraburgim nga data 07 maj 2024.

Seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit pritet të mbahet, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Pasqyra e përgjithshme sipas llojit të kallëzimit penal



Grafikoni 1: Paraqet të dhënat e përgjithshme statistikore sipas llojit të kallëzimit penal për periudhën Prill-Qershor 2024